



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 37 DATË 09/07/2021

MBI MIRATIMIN PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE KOMISIONIT EKONOMIK FINANCË – BUXHET, TATIM – TAKSA I KËSHILLIT BASHKIAK “DIMAL” PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMAVE EKONOMIKE NGA BUXHETI I SHTETIT 6 % DHE FONDEVE TË BASHKISË DIMAL.

Këshilli i Bashkisë Dimal ,në mbledhjen e tij të datës 09/07/2021, në mbështetje të materialit të paraqitur nga Sektori i Ndihmës Ekonomike pranë Bashkisë Dimal ,në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore” Neni 8 pika 2, Neni 9 , Neni 54 “Detyrat dhe Kompetencat e Keshillit Bashkiak”, pika “k” miraton norma, standarte e kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik, gërma “n” vendos për rregullat , procedurat dhe mënyrën e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te bashkia. Neni 55, Ligji 44/2015 “ Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqiperise, “VKB nr. 14 datë 06.09.2019 ”Mbi miratimin e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Ura Vajgurore, “VKB nr. 32, datë 10.10.2019 “Mbi miratimin e disa shtesave/plotësimeve të VKB nr.13, datë 06.09.2019 të Komisioneve të Përhershëm të Këshillit Bashkiak Ura Vajgurore, ne mbështetje të nenit 42/1 te Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Per Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar , Udhezimit nr. 8, datë 08.05.2017 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 955, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve , të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”. Ligj Nr 34/2021 datë 16.03.2021 ”Për Ndryshimin e Emërtimit të Njësisë së Qeverisjes Vendore nga “Bashkia Ura Vajgurore” në “Bashkia “Dimal”,Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Numri 55 e Enjte ,8 Prill 2021.

VENDOSI:

Me 14 vota PRO nga 14 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë:

1. Delegimin e kompetencave Komisionit Ekonomik Financë –Buxhet, Tatim–Taksa Këshillit Bashkiak Dimal, për miratimin e dhënies së ndihmave ekonomike nga Buxheti i Shtetit 6 % dhe ndihmave ekonomike nga buxheti/fondet e Bashkisë Dimal .
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Ekonomik Financë - Buxhet Tatim-Taksa i Këshillit Bashkiak Ura Vajguore, Sekretari i Këshillit Bashkiak, Sektori i Ndihmës Ekonomike, Drejtoria e Financës në Bashkinë Dimal.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha



